



**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY**

**PSH.nr. 633/18**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE: ‘QendrimGashi’”B.I.NTP”Deli kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku për kontratë është rekomanduar OE “ Minibus “Naim Gashi”Shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: “Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve” me nr. të prokurimit:, 616-18-1689-2-1-1, Lot 20, te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më datë: 06.12.2018, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. REFUZOHET**, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik:Qëndrim Gashi”B.I.NTP”Deli , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve” me nr. të prokurimit:, 616-18-1689-2-1-1, Lot 20, te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

**II. VËRTETOHET** , njoftimi për dhënie të kontratës i Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal i Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve” me nr. të prokurimit:, 616-18-1689-2-1-1, Lot 20.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Qëndrim Gashi”B.I.NTP”Deli, refuzohet si e pa bazuar, i bëhet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Data e Njoftimit për kontratë: 18.07.2018

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt.:08.2018

Data e njoftimi për dhënien e kontratës është bërë me dt: 18.10.2018( LLote ).

Data e njoftimi me letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm është bërë me dt: 26.09.2018

Kundër njoftimit për dhënien të kontratës operatori ekonomik “Qëndrim Gashi”B.I.NTP”Deli, me dt: 28.10.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 30.10.2018, Autoriteti kontraktues- Kuvendi Komunal i Prishtinës, ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik: “Qëndrim Gashi”B.I.NTP”Deli si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues: “Qëndrim Gashi”B.I.NTP”Deli, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me dt. 07.11.2018, me nr. 633/18, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: “Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve” me nr. të prokurimit:, 616-18-1689-2-1-1, Lot 20, te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet:1, 9.2, 6, 7, 10, 51, 56, 59, 65, 66, 67, 68, 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 16.11.2018, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese, në raportin e dt: 26.11.2018. Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues,së AK ka bërë shkelje te nenit 1 dhe neni 6 i LPP-se ,Eksperti shqyrtues mendon se nuk ka shkelje pasi AK Komuna e Prishtinës ka për zgjedh ofertën e përgjegjshme me çmim më të ulët, si i tillë ky pretendimi është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin e OE ankues ne lidhje me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale neni 9.2 duke cekur se OE MINIBUS “NAIM GASHI”i rekomanduar për kontratë ka sjellë një Konstatim te ri në lidhje me Referencën në vlerë prej 10.360,00 € , dhe se AK nuk është dashur të pranoj këtë Konstatim pasi



që është i paligjshëm , bazuar në të dhënat që ka në dispozicion Eksperti shqyrtues, AK ka vepruar në harmoni me dispozitat ligjore në lidhje me Referencat duke qene se është përfshirë edhe viti 2015 nga lista e kontratave të realizuara dhe të dorëzuara nga ana e OE-ik , ku përmes këtij Konstatimi AK është bindur se Referenca është Valide. Duke u bazuar në këto fakte eksperti shqyrtues vërteton se Konstatimi është me datë 04.10.2018 dhe Referenca e dorëzuar nga Drejtori i shkollës nuk është e kompletuar me të dhënat e nevojshme pranoj pretendimi i operatorit ekonomik ankues është pjesërisht i bazuar.

#### Përgjigje në Pretendimi nr3

Me tutje OE pretendon edhe në lidhje me Kapaciteti ekonomik dhe financiar ku OE përmend edhe qarkullimit financiar se nuk e ka përmbushur OE i rekomanduar për kontratë, Eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar qarkullim financiar , nuk ka qenë kriter dhe nuk ka aplikuar Kërkesat dhe as dëshmitë tek kushtet për pjesëmarrje të paraqitura në FTD dhe Njoftim për Kontrate dhe si i tillë ky pretendim i OE ankues nuk qëndron.

#### Përgjigje në Pretendimi nr4

Pretendimi tjetër i OE ankues lidhur me transportin e nxënësve dhe arsimtareve të vitit 2010/2016 se Operatori Ekonomik Minibus "Naim Gashi" nuk është siç e ka dërguar Listën e Kontratave , AK , Komuna e Prishtinës ka deklaruar se OE në cilësinë e punëtorit tek “ Hani Trans” ka bërë transportin e nxënësve dhe arsimtareve në aktivitetin me nr 616 11 169 211 dhe pasi është bërë njoftimi për anulimin e aktivitetit OE Minibus Naim Gashi "në cilësinë e personit juridik ka bërë bartjen e nxënësve dhe arsimtarëve deri më datën 25.12: 2015, me ç'rast edhe i është lëshuar referenca për tri vitet e fundit duke përfshirë edhe këtë 2015 bazuar në këto të dhëna eksperti shqyrtues vlerëson se janë përmbushur kriteret e kërkuara në pikën 9.1 dhe 9.2 të FID për atë periudhë dhe si i tillë ky pretendim është i pa qëndrueshëm.

#### Përgjigje në Pretendimi nr5:

Sa i përket pretendimit nën pikën 5 se Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhënien e kontratës nuk ka bërë bartjen e nxënësve dhe arsimtareve gjatë vitit 2015/2016 eksperti shqyrtues duke u bazuar në të dhënat që përmban Referenca e lëshuar nga Drejtori i Shkolles "Isa Boletini" "ne Busi , Vehbi Gashi ku Referenca përmban të dhëna të kundërta në lidhje me pretendimet e OE ankues ku , Drejtori i Shkollës "Isa Boletini" konstaton se OE Minibus "Naim Gashi" ka kryer shërbime për raportim: "Lagja Myrtaj - Shkolle" gjatë vitit 2015/2016. Bazuar në dëshmitë që eksperti posedoi pretendimi është i pa bazuar.

#### Përgjigje në Pretendimi nr6:

Pretendimi i radhës nga ana e OE-ik ankues ne lidhje me antarin e Komisionit te rivlerësimit Mentor Dragusha ,në të dhënat qe posedoj eksperti shqyrtues nga Autoriteti Kontraktues është formuar Komisioni për ri-vlerësimin e ofertave, ku njeri nga anëtarët është edhe Mentor Dragusha por eksperti shqyrtues mendon se nuk ka baze që të dyshoj se ekziston Konflikt Interesi siç pretendon OE ankues për shkak se ka lëshura një Reference për OE të rekomanduar për kontratë dhe të mos marrë pjesë në vlerësime të aktiviteteve tjera qe zhvillohen nga Komuna dhe caktohet nga qe të kryej detyrën e anëtarit të Komisionit te rivlerësimit të caktuara nga Drejtoria për Arsim besoj se do të ishte e paligjshme sikur të mos i përgjigjet kërkesave të arsyeshme te OE-ve, Referenca duhet lëshuar në përputhshmëri me shërbimet e kryera. Prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr7:

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë “Naim Gashi “ tek Lista e Kontratave nuk e përmbush aspak kriterin e përcaktuar në vlerën minimale prej 20,000.00 euro të kërkuar nga AK në dokumentacionin qe posedoj eksperti shqyrtues rezulton se OE “Naim Gashi”i rekomanduar për kontrate ka ofruar referenca tek Autoriteti Kontraktues dhe vlera e tyre e tejkalon minimum prej 20,00000€,prandaj si i tillë ky pretendim ankimor nuk është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr 8:

Sa i përket qarkullimit bankar eksperti shqyrtues sqaron se nuk ka qenë kriter i Dosjes se tenderit dhe Njoftimit për Kontratë.

Përgjigje në Pretendimi nr 9 dhe 10:

Përsëri OE ankues pretendon se referencat e lëshuara nga Menaxheri i projektit Mentor Dragusha dhe Drejtori i shkollës Vehbi Gashi nuk janë te vlefshme , pas shqyrtimit të lendes eksperti shqyrtues vërteton se referenca e lëshuar përmban datën 30.08.2018 ashtu siç ceket ne dyshimet e OE ankues , Menaxheri i projektit është dashur qe këtë referencë ta lëshoj me vërejtjeje nëse kontrata akoma nuk ka përfunduar . Autoriteti Kontraktues është kompetent që të merret me saktësimin e Referencave dhe bazuar në dëshmitë , Referencën e ka konsideruar se përmban të gjitha elementet juridike të saj dhe ka konstatuar të vlefshme në bazë të kriterëve të përcaktuara në FTD dhe si i tillë ky pretendim i OE është pjesërisht i bazuar.

9) Përgjigje në Pretendimi nr11:

Me tutje OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për dhënien e kontratës nuk e ka plotësuar formularin e tenderit si duhet bazuar ne te dhënat qe posedon eksperti shqyrtues OE i rekomanduar për kontrate ka



plotësuar formularin e tenderit me çmim ditor dhe me vlerë i cili është cituar me fjalë (shkronje për shkronje) për te dy lotet dhe në nuk kemi të bëjmë me asnjë shkelje ose gabim plotësimit të formularit.

Kurse sa i përket Certifikatës e Gjykatës Kompetente se OE I rekomanduar për dhënie e kontratës MINIBUS "NAIM GASHI" ka dorëzuar për person fizik dhe jo për person juridik në lidhje me këtë pretendim, AK po me datë 26.09,2018, ka kërkuar nga të gjithë OE për rekomandim për dhënien e kontratës që të sjellin Vërtetimin e Tatimeve dhe Vërtetimin nga Gjykata Themelore - Departamenti për Çështje Administrative deri me datë 28.09 2018. OE MINIBUS "NAIM GASHI" ka pasur Certifikatën nga Gjykata themelore për person fizik por ekspertit shqyrtues vërteton se në dosjen e OE gjendet edhe Certifikata nga Gjykata Themelore për person juridik dhe shkresat e e-mailit të datës 26.09.2015, bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim si i tillë është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.12

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se në këtë vlerësim që është bërë nga AK, në si OE-ik I përgjegjshëm jemi diskriminuar dhe nuk jemi trajtuar në mënyrë të barabartë konform LPP pasi në letrën standarde na është thënë se jeni i papërgjegjshëm sepse keni dorëzuar dy ofertë njëra në mënyrë fizike dhe tjetra në mënyrë elektronike

Eksperti shqyrtues bazuar në dokumentet në dispozicion, raportin e hapjes dhe rivlerësimit, AK –Komuna e Prishtinës ka vepruar në harmoni me Rregullat dhe udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik pika 27.5 dhe 27.6 si në vijim:

27.5. OE- nuk lejohen të prezantojnë një tender si individual dhe si anëtarë të një grupi në të njëjtën kohë në një aktivitet të prokurimit. Grupi i OE nuk do të modifikohet pas dorëzimit të tenderit (fazës së vlerësimit), nëse ndodhë kjo atë herë tenderi do të refuzohet.

27.6 Nëse një Operator Ekonomik në një aktivitet të prokurimit të ndarë LOT-e, në njërin Lot konkurron si i vetëm, ndërsa në një Lot tjetër në grup, kjo kompani nuk mund të dorëzojë deklaratën që konfirmon se ai anëtar nuk është duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në të njëjtën procedurë të prokurimit dhe rrjedhimisht të dy oferta të refuzohen.

Bazuar në ato që u cek me lartë OE i eliminuar në konsorcium "QENDRIM GASHI" BI dhe NTP DELI janë të eliminuar sipas dorëzimit të ofertave për të njëjtin Aktivitet edhe në mënyrë fizike dhe në mënyrë elektronike

Si rrjedhojë e kësaj Grupi i Operatoreve ekonomik nuk mund të dorëzojnë deklaratën të cekur me lartë me qenese dëshmitë rezultojnë se AK ka bazë ligjore për të ju konsideruar të pa përgjegjshëm për shkak se keni

dorëzuar ofertën në mënyrë elektronike dhe fizike prandaj Eksperti shqyrtues bazuar në të dhënat e cekura me lartë ky pretendimi i OE “QendrimGashi”B.I. nuk është i bazuar.

Eksperti shqyrtues bazuar në konstatimet e lartë cekura në ekspertizën e bërë mendon që AK-es Komuna e Prishtinës për aktivitetin e prokurimit “Transporti i nxënëseve” me nr. të prokurimit: 656/17/3725/5-1-1, ka shpërblyer me kontratë Minibus “Naim Gashi” shpk, Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtuesi propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, kthimi në rivlerësim nuk do të ndryshoj rezultatin e AK- Komuna e Prishtinës, dhe rekomandon që të mbete në fuqi Vendimi i AK-ës –Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

Operatori Ekonomik “Qëndrim Gashi”B.I.NTP”Deli,, me datë: 30.11.2018 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues – Kuvendi Komunal i Prishtinës, me datë: 03.12.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 06.12.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, eksperti shqyrtues i OSHP-së, OE ankues është njoftuar dhe është ftuar për seancën e dt.06.12.2018, mirëpo të njëjtit për arsye të panjohura për panelin , nuk përfaqësojnë në seancë, andaj paneli vendosi që seanca të vazhdoj pa praninë e përfaqësuesit të OE-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për dhënie të kontratës, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z.Sallahu deklaroi: Ne e mbështesim ekspertizën e ekspertit shqyrtues, me cilin rast mbështesim edhe vendimin që kemi nxjerr pas kërkesës për rishqyrtim dhe pretendimet e pa bazuara të OE ankues. OE ankues është eliminuar sepse i njëjti ka aplikuar për këtë aktivitet të prokurimit edhe në formë fizike edhe në formë elektronike, ku neni 27.6 të UOPP-së theksohet “nëse OE-të aplikojnë në mënyrë elektronike dhe fizike për njëjtin aktivitet atëherë të dy OE refuzohen”. Po në këtë lot.20 lideri i grupit Qëndrim Gashi nuk ka asnjë referencë të kryer në emër të tij për shërbimet e transportit (edhe po të ishte shqyrtuar), mirëpo referencë ka vetëm anëtari i grupit Deli. Dispozitat ligjore përcaktojnë se nëse njëri anëtari i grupit ka ofertuar në formë fizike pasi ka ofertuar në formë elektronike dy ofertat



refuzohen. I propozojmë panelit të vërtetoj vendimin e AK-së si të bazuar dhe të refuzohet ankesa e OE ankues si e pabazuar.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertit shqyrtues profesionale znj.Zejnullahu deklaroj: Shumica pretendimeve ankimore janë rreth referencave, dhe OE është thirr në qarkullim bankare mirëpo të cilin AK nuk e ka kërkuar fare. Po ashtu pretendim ankimorë është se AK e ka eliminuar pse ka ofertuar në mënyrë elektronike dhe fizike, mirëpo duke thënë se kanë drejtë të konkurrojnë në tri lote. Qëndron fakti se kanë drejtë aplikimi për tri lote, mirëpo kjo duhet bërë përmes ofertimit në dy forma edhe elektronike dhe fizike. Arsyeja pse kam rekomanduar që të aprovohet pjesërisht si e bazuar është se njëra referencë ka qenë e paqartë mirëpo e cila gjatë rishqyrtimit është sqaruar mjaftueshëm. Qëndroj pranë raportit të ekspertizës dhe konstatimeve të dhëna në raport.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, lidhur me pretendimin e OE ankues, së AK ka bërë shkelje të nenit 1 dhe neni 6 i LPP-së , konstaton se ky pretendimi është i pabazuar sepse nuk ka shkelje të LPP-së nga ana e AK Komuna e Prishtinës sepse AK-ja ka përzgjedh ofertën e përgjegjshme me çmim më të ulët.

Lidhur me pretendimin e OE ankues në lidhje me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale neni 9.2 duke cekur se OE MINIBUS “NAIM GASHI”, i rekomanduar për kontratë ka sjellë një Konstatim të ri në lidhje me Referencën në vlerë prej 10.360,00 € , dhe se AK nuk është dashur të pranojë këtë Konstatim pasi që është i paligjshëm . Paneli shqyrtues konstaton se AK ka vepruar në harmoni me dispozitat ligjore në lidhje me Referencat.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka përmbushur qarkullimin financiar, Paneli shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar qarkullim financiar, nuk ka qenë kriter dhe nuk ka aplikuar Kërkesat dhe as dëshmitë tek kushtet për pjesëmarrje të paraqitura në FTD dhe Njoftim për Kontrate, e që AK-ja, nuk mund të vlerësojë një oferte si jo të përgjegjshme për kërkesat të cilat nuk kanë qenë në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë, kjo gjë është e rregulluar edhe me nenin 56.3 të LPP-së, në të cilin thuhet: Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave të negociuara, pas publikimit të njoftimit të kontratës, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.



Lidhur me pretendimin e OE ankues lidhur me transportin e nxënësve dhe arsimtareve të vitit 2010/2016, ku ankuesi pretendon se Operatori Ekonomik Minibus "Naim Gashi" nuk është siç e ka dërguar Listën e Kontratave, AK Komuna e Prishtinës ka deklaruar se OE në cilësinë e punëtorit tek "Hani Trans" ka bërë transportin e nxënësve dhe arsimtareve në aktivitetin me nr 616 11 169 211 dhe pasi është bërë njoftimi për anulimin e aktivitetit OE Minibus Naim Gashi "në cilësinë e personit juridik ka bërë bartjen e nxënësve dhe arsimtarëve deri më datën 25.12. 2015, me ç'rast edhe i është lëshuar referenca për tri vitet e fundit duke përfshirë edhe këtë 2015, Paneli shqyrtues lidhur me këtë që u cek si më lart bazuar në këto të dhëna vlerëson se janë përmbushur kriteret e kërkuara në pikën 9.1 dhe 9.2 të FID për atë periudhë dhe si i tillë ky pretendim është i pa qëndrueshëm.

Sa i përket pretendimit të ankuesit se Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhënien e kontratës nuk ka bërë bartjen e nxënësve dhe arsimtareve gjatë vitit 2015/2016, Paneli shqyrtues duke u bazuar në të dhënat që përmban Referenca e lëshuar nga Drejtori i Shkolles "Isa Boletini" "ne Busi, Vehbi Gashi, ku Referenca përmban të dhëna të kundërta në lidhje me pretendimet e OE ankues ku, Drejtori i Shkollës "Isa Boletini" konstaton se OE Minibus "Naim Gashi" ka kryer shërbime për raportim: "Lagja Myrtaj - Shkolle" gjatë vitit 2015/2016, andaj duke u bazuar në sqarimet e ekspertit shqyrtues profesional konstatohet se është i pa bazuar ky pretendim i ankuesit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, në lidhje me anëtarin e Komisionit të rivlerësimit Mentor Dragusha, Paneli shqyrtues sqaron se nga Autoriteti Kontraktues është formuar Komisioni për ri-vlerësimin e ofertave, ku njeri nga anëtarët është edhe Mentor Dragusha por, nga të dhënat që kemi pasur në shqyrtim nuk ka baze që të dyshoj se ekziston Konflikt Interesi siç pretendon OE ankues për shkak se i njëjti anëtar i komisionit ka lëshuar një Reference për OE të rekomanduar për kontratë dhe të mos marrë pjesë në vlerësime të aktiviteteve tjera që zhvillohen nga Komuna, prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit, se OE i rekomanduar për kontratë "Naim Gashi" tek Lista e Kontratave nuk e përmbush aspak kriterin e përcaktuar në vlerën minimale prej 20,000.00 euro të kërkuar nga AK në dokumentacionin që posedoj, Paneli i shqyrtues sqaron se OE "Naim Gashi" i rekomanduar për kontratë ka ofruar referenca tek Autoriteti Kontraktues dhe vlera e tyre e tejkalon minimum prej 20,000,000€, prandaj si i tillë ky pretendim ankimor nuk është i qëndrueshëm.

Po ashtu sa i përket pretendimit të OE ankues se referencat e lëshuara nga Menaxheri i projektit Mentor Dragusha dhe Drejtori i shkollës Vehbi Gashi nuk janë të vlefshme, Paneli shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues është kompetent që të merret me saktësimin e Referencave dhe bazuar në dëshmitë,



AK-ja këtë Referencë e ka konsideruar se përmban të gjitha elementet juridike të saj dhe ka konstatuar të vlefshme në bazë të kritereve të përcaktuara në FTD dhe si i tillë ky pretendim i OE është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se OE i rekomanduar për dhënien e kontratës nuk e ka plotësuar formularin e tenderit si duhet, Paneli shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për kontratë ka plotësuar formularin e tenderit me çmim ditor dhe me vlerë i cili është cituar me fjalë (shkronje për shkronje) për të dy lotet dhe nuk kemi të bëjmë me asnjë shkelje ose gabim plotësimit të formularit. Kurse sa i përket Certifikatës e Gjykatës Kompetente, ku ankuesi pretendon se OE i rekomanduar për dhënie e kontratës MINIBUS "NAIM GASHI" ka dorëzuar për person fizik dhe jo për person juridik, Paneli shqyrtues konstaton se AK po me datë 26.09.2018, ka kërkuar nga të gjithë OE për rekomandim për dhënien e kontratës që të sjellin Vërtetimin e Tatimeve dhe Vërtetimin nga Gjykata Themelore - Departamenti për Çështje Administrative deri me datë 28.09.2018. OE MINIBUS "NAIM GASHI" ka pasur Certifikatën nga Gjykata themelore për person fizik por eksperti shqyrtues ka vërtetuar se në dosjen e këtij OE gjendet edhe Certifikata nga Gjykata Themelore për person juridik, andaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i ankuesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se në këtë vlerësim që është bërë nga AK, në si OE-ik i përgjegjshëm jemi diskriminuar dhe nuk jemi trajtuar në mënyrë të barabartë konform LPP pasi në letrën standarde na është thënë se jeni i papërgjegjshëm sepse keni dorëzuar dy ofertë njëra në mënyrë fizike dhe tjetra në mënyrë elektronike

Paneli shqyrtues bazuar në dokumentet që ka pas në dispozicion, konstaton se AK –Komuna e Prishtinës, kur e ka eliminuar OE ankues me arsyet e cekura si më lart ka vepruar në harmoni me Rregullat dhe udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik pika 27.5 dhe 27.6, në të cilin thuhet:

27.5. OE- nuk lejohen të prezantojnë një tender si individual dhe si anëtarë të një grupi në të njëjtën kohë në një aktivitet të prokurimit. Grupi i OE nuk do të modifikohet pas dorëzimit të tenderit (fazës së vlerësimit), nëse ndodhë kjo atë here tenderi do të refuzohet.

27.6 Nëse një Operator Ekonomik në një aktivitet të prokurimit të ndarën LOT-e, në njërin Lot konkurron si i vetëm, ndërsa në një Lot tjetër në grup, kjo kompani nuk mund të dorëzojë deklaratën që konfirmon se ai anëtar nuk është duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në të njëjtën procedurë të prokurimit dhe rrjedhimisht të dy oferta të refuzohen.

Paneli shqyrtues sqaron se bazuar në ato që u cek më lartë, shihet se OE i eliminuar në konsorcium "QENDRIM GASHI" BI dhe NTP DELI, janë të eliminuar sipas dorëzimit të ofertave për të njëjtin

Aktivitet edhe ne mënyrë fizike dhe në mënyrë elektronike . Si rrjedhojë e kësaj Grupi i Operatoreve ekonomik nuk mund të dorëzojnë deklaratën të cekur me lartë me qenese dëshmitë rezultojnë se AK ka bazë ligjore për të ju konsideruar të pa përgjegjshëm për shkak se keni dorëzuar ofertën në mënyrë elektronike dhe fizike prandaj bazuar në të dhënat e cekura me lartë ky pretendimi i OE “Qendrim Gashi”B.I. nuk është i bazuar.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Po ashtu autoritetet kontraktuese ka vepruar ne harmoni me nenin 6 të LPP-së ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Gjithashtu autoriteti kontraktues ka vepruar në pajtim me nenin 59 dhe 60 të LPP-së për faktin se ka rekomanduar për dhënie të kontratës operatorin ekonomik i cili ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe ka ofertuar me çmim me te lire nga te gjithë ofertuesit e përgjegjshëm.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK - Kuvendi Komunal i Prishtinës
- 1x1 OE - QendrimGashi”B.I.NTP”Deli
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.